


feluete uat
pa' procedurat, votues
dhe Efiliu




KUVENDI
NR. 3876 DATE 15.12.23

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ / ____ / 2023

Lënda: Kërkesë për marrjen e masës disiplinore.

Drejtuar: Znj. Lindita NIKOLLA

KRYETARE E KUVENDIT TË SHQIPËRISË

Baza Ligjore: Neni 63, pika 1 gërma d), dhe neni 65/1 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë,
Neni 3, gërma dh) dhe ë), neni 8, pika 2 gërma b) dhe neni 33 i Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

E nderuar zonja Kryetare,

Seanca e datës 14.12.2023 u zhvillua mes zhurmës dhe sjelljeve të dhunshme nga deputetët e opozitës. Veprimet e paprecedenta dhe në shkelje të etikës parlamentare përpara zhvillimit të seancës plenare, ku deputetë të caktuar të opozitës penguan hyrjen e deputetëve të mazhorancës dhe të vetë opozitës, bien ndesh me Kodin e Sjelljes së Deputetit.

Këto sjellje të dhunshme vijuan edhe brenda sallës së seancës plenare ku për të disatën herë dhe në mënyrë të përsëritur deputetë të opozitës kanë ndezur disa flakadanë si dhe kanë bërë zhurmuesin duke përplasur tavolinat apo duke bërtitur, në mënyrë që seanca plenare të mos zhvillohej normalisht. Situata aspak normale e krijuar prej tyre, në thyerje të rëndë të Rregullores së Kuvendit dhe Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Shqipërisë bënë që Kryetarja e Kuvendit të kalonte në procesin e votimit, pa u zhvilluar diskutimet sipas rendit të ditës ku deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste ishin regjistruar për të folur.

Me fillimin e seancës plenare, deputetët Edmond Spaho dhe Saimir Korreshi përdorën mjete piroteknike (flakadanë) duke ndezur disa të tilla. Disa prej flakadanëve dy deputetëve Spaho dhe Korreshi u'a ka dhënë deputeti Kastriot Piroli, i cili në disa raste nxjerr flakadanët dhe dy deputetët e tjerë i ndezin. E gjithë kjo situatë ka krijuar zhurmë dhe kaos në sallën e seanceve.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 63, pika 1 gërma d), dhe nenit 65/1 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 3, gërma dh) dhe e), nenin 8, pika 2 gërma b) dhe nenin 33 të Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, paraqesim kërkesën :

- Marrjen e masës disiplinore ndaj deputetëve Edmond Spaho, Saimir Korreshi dhe Kastriot Piroli sipas Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

- Mbledhjen e Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën për vlerësimin e masës disiplinore.

DEPUTETËT :

Shi Metyf

Agim Bolla Ag

Florenc Saho

4. Gypresa Harroj

5. Mir Topi

6. Mirela Pitushi

7. Gerta Duraku

8. Zeynep Remye

9. DENIS DELIU

10. Zoljeta Bozo

11. SHKELPZ Jullan